



PHARMA

KENDY SUISSE AG 



**Për një shtatzënësi
të shëndetshme dhe
një jetë pa Anemi**

**400µg dozë e rekomanduar ditore nga *APA
për një shtatzënësi normale**

**APA- American Pregnancy Association*

Përfaqësues ekskluziv për Kosovë & Shqipëri:



Pharma
plus

Kalabria e re, Rr. "Rexhep Krasniqi" pn,
Blloku C2, Objekti B, nr. 1,
10000 Prishtinë - Kosovë
Tel&Fax: +381(0)38 713 776
Mob. +377 (0)45 601 503, +377 (0)45 601 508
E-mail: pharmaplusllc@gmail.com

Acidi folik

Acidi folik është vitaminë hidrosolubile (vitamina B₉) dhe ka një rëndësi të madhe në zhvillimin normal të strukturave qelizore të njeriut.

Acidi folik është i domosdoshëm për formimin e placentës dhe zhvillimin normal të fetusit. Mungesa e acidit folik ka për pasojë dëmtimin e riprodhimit qelizor që në anën tjetër mund të rezultojë me anomalinë e njohur si *spina bifida*, një defekt kongjenital i shtyllës kurrizore.

Indikacionet

- Trajtimin dhe parandalimin e mungesës së acidit folik te gratë shtatzëna
- Uljen nivelit të homocisteinës në njerëz me sëmundje të veshkave
- Zvoglimin e efekteve të padëshiruara të metotreksatit (vjellja dhe neveria)
- Uljen e rrezikut të kancerit kolorektal
- Uljen e rrezikut të kancerit të gjirit
- Te gjendjen e depresionit, kur përdoret me barna antidepressive konvencionale
- Trajtimin e vitiligos
- Çrregullimet e mukozës së gingivave gjatë marrje së fenitoinës
- Trajtimin e infeksioneve të mukozës së gojës gjatë shtatzënësisë
- Zvogëlimi i rrezikut nga kanceri pankreatik
- Parandalimin e degjenerimit makular

Efektet tjera të dobishme

- Parandalimi i ri-blokimit të enëve të gjakut pas angioplastikës
- Parandalimin e sëmundjes Alzheimer
- Ngritë kapacitet e memories dhe aftësitë e të menduarit në njerëz të moshuar
- Parandalimi i kancerit të qafës së mitrës.
- Parandalimi i infertilitetit mashkullor
- Uljen e rrezikut nga kanceri i mushkërive
- Parandalimin e kancerit te pacientët me kolit ulceroz
- Te sëmundjet e mëlçisë
- Tek alkoolizmi
- Tek osteoporoz

Dozimi

Te gratë shtatzëna dhe periudhën e gjdhënies: **400-600 mcg (mikrogramë) /ditë**

Te deficienca e acidit folik: **250-1000 mcg në ditë.**

Për të parandaluar defektet e tubit neural te fetusit: **të paktën 400 mcg e acidit folik/ditë;**

Te gratë shtatzëna me histori te defekteve të tubit neural nervor: deri 4 mg ditë një muaj më parë dhe vazhdon për tre muaj pas mbarësimit.

Për reduktimin e rrezikut të kancerit të zorrës së trashë: **400 mcg në ditë.**

Për trajtimin e niveleve të larta të homocisteinës në gjak: **0,5-5 mg (miligram)/ditë**

Për te përmirësuar përgjigjen terapeutike te barnave kundër depresionit: **200-400 mcg/ditë**

Për vitiligo: **5 mg/ 2herë në ditë**

Për uljen e toksicitetit te terapia me Methotrexate: **1 mg/ditë**, terapia maksimale ditore deri **5 mg/ditë.**

Për të parandaluar degjenerimin makular: **acid folik 2,5 mg**, vitaminë B12 (cyanocobalamin) **1000 mcg**, dhe vitaminë B6 (pyridoxine) **50 mg në ditë.**

Dozimi te fëmijët:

Foshnjat 0-6 muaj: **65 mcg;**

Foshnjat 7 – 12 muaj: **80 mcg;**

Fëmijët 1-3 vjeç, **150 mcg;**

Fëmijët 4-8 vjeç, **200 mcg;**

Fëmijët 9-13 vjeç, **300 mcg;**

Të rriturit mbi 13 vjeç, **400 mcg;**

Profili i sigurisë/ Efektet anësore

Shumica e të rriturve nuk përjetojnë asnjë efekt anësor kur marrin sasinë e rekomanduar prej 400 mcg (mikrogramë) të acidit folik.

Doza të larta të acidit folik mund të shkaktojë dhimbje të barkut, diare, skuqje, çrregullime të gjumit, iritim, konfuzion, mundim në stomak, ndryshime në sjellje, reaksione në lëkurë, shqetësim dhe efekte të tjera anësore.

Ka disa të dhëna nga hulumtimet klinike se marrja e dozave të larta të acidit folik për një periudhë të gjatë kohore mund të shkaktojë efekte të rënda anësore.

Disa hulumtime tregojnë se marrja e acidit folik në doza prej 800-1200 mcg mund të rrisin rrezikun e sulmit në zemër te njerëzit që kanë sëmundje kardiake.

Disa hulumtime tjera raportojnë se duke marrë këto doza të larta mund të rritet rreziku i kancerit të mushkërive apo format tjera si kanceri i prostatës.

Marrja e dozave mbi 1000 mcg (1mg) në ditë mund të maskojë shenjat e deficiencës së Vitaminës B12, ndërsa dozat e larta mbi 5000 – 20000 mcg te gratë shtatzëna mund të dëmtojnë sistemin nervor qëndror te fetusit.

Ndërveprimet e mundshme me barnat janë: 5-fluorouracil, Capecitabine, Fosphenytoin, Methotrexate, Phenobarbital, Phenytoin, Primidone, Pyrimethamine

Ndërveprimi i mundshëm me ushqim dhe pije: raportohet për ndërveprim me çajin e gjelbërt prandaj nuk rekomandohet te merret njokohësisht me acidin folik.

Referencat: American Pregnancy Association; Folic Acid; October 2008; American Pregnancy Association; Symptoms of Overdose; October 2008; Drugs.com; Folic Acid; October 2009; Mayo Clinic; Folate (Folic Acid); April 2011; New York Times Health Guide; Folic Acid in Diet; David Zieve; November 2009